



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për parandalimin e torturës,
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/319
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.

Tiranë ___/___/2023

Nr. Dok. 202300376/19

Lënda: *Rekomandime për zbatimin me korrektësi të rasteve dhe kritereve ligjore të ndalimit/arrestimit të shtetasve të cilët marrin "Metadon" dhe janë përdorues të lëndëve narkotike nga punonjësit e Policisë së Shtetit dhe trajtimin e tyre me dinjitet në përputhje me aktet normative në fuqi.*

Drejtuar: **Z. Muhamet RRUMBULLAKU**
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

TIRANË

Drejtues i parë Tonin VOCAJ
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë

TIRANË

Të nderuar,

Sikurse ju kemi vënë në dijeni më datë 02.05.2023 është regjistruar rasti i bërë publik në media, "I riu në koma pas arrestimit". Sipas lajmit, Jani Rustemi 27 vjeç, ra në gjendje kome në QSUT pasi u arrestua nga policia në Tiranë më datë 12 Prill 2023. Arrestimin e tij e kishin kryer shërbimet policore të Komisarariatit Nr.2 Tiranë. I riu ishte arrestuar për vjedhjen e një tapeti dhe një palë atleteve, por 5 ditë më vonë më 17 Prill, Jani Rustemi dërgohet në Urgjencën e QSUT-së në gjendje të rëndë. Më datë 20.05.2023, shtetasi Jani Rustemi ka ndërruar jetë në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë. E ëma e të riut, Pranvera Rustemi ka denoncuar ngjarjen e ndodhur në emisionin Uniko tek gazetari Spartak Koka në Klan Plus, duke pretenduar se policia nuk i ka dhënë asnjë informacion, si dhe konfirmon se në dijeni të saj djali nuk vuan nga asnjë sëmundje.

Lidhur me ngjarjen Nd/Komisionerët e Institucionit të Avokatit të Popullit përkatësisht Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit të egër çnjerëzor dhe degradues, filluan hetimin administrativ të çështjes. Me vënien në

dijeni të këtij lajmi, u ngrit grupi i punës, me qëllim verifikimin e situatës në vend, si dhe sqarimin e rrethanave të ngjarjes.

Fillimisht është marre kontakt me oficerin e policisë gjyqësore në Komisarlatin nr.2, punonjës ky që ka kryer dhe arrestimin në flagrancë të këtij shtetasi si dhe u inspektua Blloku i Sigurisë Tiranë lidhur me ngjarjen e ndodhur në këtë institucion, duke hetuar në kronologji fillestare që nga ardhja në institucion, qëndrimin në dhomën e sigurisë dhe deri në ngjarjen e ndodhur me përkeqësimin e gjendjes shëndetësore të këtij shtetasi. Sipas raportimit të kryer në datë 12.04.2023, shtetasi Jani Rustemi i datëlindjes, 15.04.1995 është vendosur në dhomat e sigurisë nga Komisarlati i Policisë Nr.2 Tiranë dhe në dt.15.04.2023 ndaj tij është caktuar masa e sigurimit personal “Arrest me burg” nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në Komisarlatin e Policisë nr.2 Tiranë u takuam me Oficerin e Policisë Gjyqësore që ka ndjekur rastin si dhe u krye këqyrja e çdo akti administrativ dhe dokumentacion që kishte lidhje me personin si regjistri i shoqërimit, procesverbali i arrestimit në flagrancë të personit, raporti i shërbimit etj.

Nga këqyrja e **raportit të shërbimit të mbajtur në dt.12.04.2023**, punonjësi i policisë të komisarlatit Nr.2 Tiranë, ka shënuar se ky shtetas ishte shumë i dhunshëm përgjatë arrestimit në flagrancë. Ai sipas procesverbalit, përplaste kokën në sediljet e makinës së Policisë, tentonte të thyente xhamin e makinës si dhe përgjatë qëndrimit në dhomën e shoqërimit, kryente veprime të papërgjegjshme duke tentuar t’i binte murit të dhomës me kokë. Avokati i Popullit duke u njohur me këto veprime vëren se punonjësit e policisë nuk kanë marrë masat e duhura për ta adresuar këtë person me veprime të çrregullta dhe të pavetëdijshme në spitalin më të afërt për t’i dhënë ndihmë mjekësore.

Ky fakt provon qartazi konstatimin tonë të herë pas hershëm se nga punonjësit e Policisë së Shtetit nuk njihen dhe nuk zbatohen sa e si duhet aktet normative në fuqi të cilat parashikojnë konceptin e shoqërimit të shtetasve në mjediset e policisë, të drejtat e të shoqëruarve dhe arrestuar/ndaluar si dhe detyrimet e punonjësve të policisë.

Sipas pikës 25 të nenit 6 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, **shoqërimi është dërgimi i shtetasit në ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit, te kujdestari ose personi përgjegjës, në institucionin urdhërdhënës ose në institucionet e tjera me ose pa vullnetin e tij, sipas përcaktimeve të bëra në nenet 109 dhe 122, pika 1, të këtij ligji.**

Referuar ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, neni 122 pikat 1 dhe 2 përcaktohet se: 1. ***Masat mbrojtëse merren ndaj personit të sëmurë mendor, në gjendje të dehur, nën efektet e lëndëve narkotike ose ndaj personit me sëmundje ngjitëse të rënda. Në këto raste, punonjësi i policisë e dërgon personin në***

ambientet e policisë, në institucionet shëndetësore, në qendrat e rehabilitimit ose e dorëzon te kujdestari apo personat përgjegjës. 2. Punonjësi i policisë merr masat e nevojshme për mbrojtjen e personit, gjendja e të cilit tregon qartë se nuk mund të kontrollojë veprimet dhe sjelljen e tij dhe për këtë arsye mund t'i shkaktojë dëmtime fizike ose të përbjëjë rrezik për jetën e tij ose të të tjerëve.”

Avokati i Popullit vlerëson të sjellë në vëmendje rëndësinë e veçantë që ka sjellja e organeve të shtetit kundrejt personave që në orët e para të shoqërimit ose arrestimit. Nisur nga veprimet që janë kryer nga punonjësit e policisë në Komisaratin Nr.2, Tiranë, rezulton se ndaj këtij personi nuk janë marrë masa për ofrimin e ndihmës mjekësore në qendrën shëndetësore më të afërt, ndonëse oficerët që kanë kryer shërbimin kanë konstatuar se ai ka shfaqur çrregullim në sjellje dhe veprime vetdëmtuese.

Gjithashtu theksojmë se një person i arrestuar/ndaluar nga policia është në një situatë të cënueshmërisë së veçantë, pasi personi është plotësisht në duart e agjentëve të zbatimit të ligjit që janë përgjegjës për shëndetin e tij. Ky çekuilibër pushteti krijon një situatë rreziku ku mund të ndodhin abuzime dhe tortura.

Masat mbrojtëse, veçanërisht në fazat e hershme të shoqërimit ose arrestim/ndalimit janë thelbësore për të parandaluar abuzimet. Këto masa përfshijnë:

- *kryerjen e ekzaminimit nga një mjek për të konfirmuar ose përjashtuar pretendimet për keqtrajtim dhe për të ofruar ndihmë mjekësore nëse është e nevojshme.*

Nga verifikimi i rastit në Bllokun e Sigurisë Tiranë, sipas deklarimeve të punonjësve, gjendja shëndetësore e z. Jani Rustemi, me ardhjen e tij në këtë institucion në orën 12.00, të datës **12.04.2023** dhe paraqitjen e tij para komisionit të pranimit, si dhe gjatë kalimit të tij në dhomë, ka qenë e mirë. Ky shtetas ka firmosur proces –verbalin, ka deklaruar se nuk ka probleme me policinë dhe se ai **është përdorues i lëndëve narkotike**.

Në datën **16.04.2023** rreth orës 10:45 në raportin e shërbimit të punonjësve të dhomave të sigurisë, shtetasi Jani Rustemi së bashku me dy persona të tjerë të cilët ishin me masë “arresti me burg” janë transportuar për në IEVP “Jordan Misja”. Në këtë raport sqarohet se dy personat e tjerë janë akomoduar në IEVP, ndërsa shtetasi Jani Rustemi është kthyer përsëri në dhomat e sigurisë.

Gjithashtu u administruan dhe u këqyr dokumentacioni lidhur me qëndrimin e personit në bllokun e sigurisë. Në librin e dinamikës, konstatuam shënimin se në dt.**17.04.2023** në orën 4:15, përgjegjësi i katit të dytë të dhomave të sigurisë njoftoi punonjësit e shërbimit se shtetasi Jani Rustemi ka nevojë urgjente për ndihmë mjekësore. Në orën 4:28 ka mbërritur në bllokun e sigurisë Ambulanca me stafin

mjekësor e më pas në orën 4:33 është transportuar me urgjencë me shenja jete për në QSUT.

Nga informacioni i marrë nga mjeku i dhomave të sigurisë u informuam se shtetasi Jani Rustemi ishte i shënuar në librin e vizitave mjekësore në rubrikën konstatime si “Toxikoman” dhe trajtohej me metadon 40 mg.

Gjithashtu në librin e dinamikës është i shënuar dhe njoftimi i familjarëve në dt.17.04.2023 ora 14:30 ku është njoftuar nëna e të ndaluarit Jani Rustemi se djali është sëmurë dhe ndodhet në spital. Aty është shënuar dhe nr. i telefonit të nënës të Jani Rustemit.

Gjithashtu institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë kontakt me drejtuesin e **Aksion Plus** z. Genci Mucollari, i cili na bëri me dije se shtetasi Jani Rustemi është trajtuar nga kjo organizatë me metadon me dozën ditore 40 mg.

Nisur nga hetimi administrativ i kryer nga Institucioni i Avokatit të Popullit si dhe duke iu referuar nenit 109 të ligjit të sipërcituar, rezulton se ky rast nuk ka marrë rëndësinë e duhur dhe është neglizhuar nga strukturat e Policisë së Shtetit në kundërshtim me procedurat standarde. Nga të gjithë verifikimet e kryera, konstatohet se ka një paqartësi nga ana e mjekut të bllokut të sigurisë në dhënien e dozës së metadonit. Kjo dozë nuk është e përcaktuar nga mjeku toksikolog dhe për më tepër nuk kemi një provë të qartë se kur ka qenë koha kur ky person ka marre për herë të fundit metadon para se të mbërrinte në dhomat e sigurisë.

Pra mjeku fillimisht duhet të kryente ekzaminimet e nevojshme të personit e më tej sipas rekomandimit të specialistit toksikolog, do të duhet t’i jepte personit të arrestuar dozën e nevojshme të metadonit. Në procesverbalin e pritjes konstatohet se personi i arrestuar ka deklaruar që është përdorues i lëndëve narkotike. Duke mbajtur në konsideratë natyrën e çështjes, në raste të tilla mund të parandalohet kjo ngjarje duke u bazuar dhe në **Procedurën standarde: “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre” ku shprehet qartë në pikën 4 se:**

4.Shërbimi shëndetësor.

- 4.1 *Pranë drejtorive vendore të policisë ngrihet dhe funksionon shërbimi shëndetësor, me personel mjekë apo ndihmës mjekë.*
- 4.2 *Vizitat mjekësore ndaj të arrestuarve/ndaluarve kryhen nga mjekë apo ndihmës mjekë të njërive policore, dhe në mungesë të tyre nga mjekë të qendrave spitalore rajonale të miratuar nga shefi komisarariatit policisë.*
- 4.3 *Për çdo vizitë/kontroll mjekësor të kryer nga personeli mjekësor, çelet dhe plotësohet kartela/dosja personale mjekësore për të arrestuarin/ndaluarin. Për të arrestuarit e ndaluarit ndaj të cilëve gjykata ka caktuar si masë sigurimi “arrest në burg” kartela plotësohet në dy kopje, një prej të cilave shoqëron personin në IEVP.*

- 4.4 *Një kopje e kartelave mjekësore mbahet dhe ruhet nga mjeku në rafte/kasaforta në dhomën e vizitave mjekësore, sipas afateve kohore të miratuara për këtë qëllim.*
- 4.5 *Në kartelën mjekësore duhet të përshkruhet anamneza, si dhe sëmundja e personit të arrestuar/ndaluar, ora e vizitës, ankesat e tyre mjekësore, si dhe mjekimi që ai merr.*
- 4.6 *Vizitat kryhen në një dhomë të caktuar për këtë qëllim brenda sistemit të dhomave të sigurisë, pa prezencën dhe vështrimin e personelit policor apo personave të tjerë, me përjashtim të rasteve kur mjeku kërkon të kundërtën.*
- 4.7 *Të dhënat e pasqyruara në kartelat mjekësore janë të pa aksesueshme ndaj stafit jo – mjekësor, me përjashtim të rasteve kur kërkohen nga organet e prokurorisë dhe të gjykatës gjatë një procesi hetimor dhe gjyqësor.*
- 4.8 *Për personat e arrestuar/ndaluar, të cilët janë përdorues të lëndëve narkotike, duhet të bëhet evidentimi i këtij fakti në kartelë, duke bërë përcaktimin e llojit e lëndës narkotike të përdorur dhe mjekimin që merret nga personi i arrestuar/ndaluar.*
- 4.9 *Për personat e arrestuar/ndaluar, të cilët marrin “Metadon”, personeli mjekësor në DVP duhet të kontaktojë dhe të mbajë lidhje me “Qendrën Aksion Plus”, si dhe të konsultohet me mjekët specialistë, për të përcaktuar llojin dhe dozën e mjekimit (Metadonit), që duhet të përdorë personi i arrestuar/ndaluar.*
- 4.10 ***Përgjegjësi i dhomave të sigurisë, në rastet kur konstaton që i arrestuari/ndaluari është përdorues i lëndëve narkotike, duhet të kontaktojë menjëherë me eprorin e tij, si dhe mjekun e strukturës policore, ku ky i fundit konsultohet me mjekun toksikolog ose në mungesë të tij me mjekët specialist në qendrat spitalore rajonale, për mjekimin dhe dozën që merr personi i arrestuar/ndaluar.***
- 4.11 *Në rastet kur personi i arrestuar/ndaluar shfaq shenjat e urgjencës mjekësore, përgjegjësi i dhomave të sigurisë, duhet ta dërgojë atë në qendrat mjekësore të specializuara. Transporti duhet të realizohet me autoambulancën e urgjencës, por në pamundësi apo vonesa në ardhjen shpejt të kësaj të fundit, mund të përdoren mjetet e transportit që disponon struktura policore.*
- 4.12 *Medikamentet për trajtimin e rasteve të urgjencave për të arrestuarit/ndaluarit sigurohen nga drejtoria/komisariati i policisë, sipas fondeve financiare të akorduara e detajuara për këtë qëllim. Me miratim dhe rekomandim të mjekut i arrestuari/ndaluari mund të përdorë dhe medikamente të siguruara nga familja.*
- 4.13 *Në rast se gjatë vizitës/kontrollit konstatohen dëmtime fizike, plagë apo gjakrrjedhje, etj, mjeku/ndihmës mjeku i njësisë policore dhe specialisti i shërbimeve të rendit marrin masa të menjëhershme për dërgimin e tij në qendrën më të afërt spitalore për ti dhënë ndihmën e nevojshme*
- 4.14 *Nëse një i ndaluar apo arrestuar vuan nga sëmundje kronike dhe për këtë është nën trajtimin e medikamenteve, merren masa për mos ndërprerjen e trajtimit. Dhënia e medikamenteve bëhet sipas këshillave të mjekut specialist apo mjekut të njësisë policore.*
- 4.15 *Personeli policor i ngarkuar me ruajtjen, sigurimin dhe trajtimin e të arrestuarve/ndaluarve për çdo ankesë, kërkesë për ndihmë e shqetësime shëndetësore, të marra nga të ndaluarit/arrestuarit, njofton menjëherë shërbimin e Sallës Komandës dhe Kontrollit dhe eprorin e drejtpërdrejtë dhe këta të fundit njoftojnë mjekun/ndihmës mjekun e njësisë policore.*

- 4.16 Në varësi të gjendjes së personit të ndaluar/arrestuar dhe në pamundësinë e ardhjes në mënyrë të menjëhershme të mjekut/ndihmësmjekut të njësisë policore, i ndaluari/arrestuari dërgohet në qendrën spitalore më të afërt për të marrë ndihmën e duhur. Në këtë rast personeli mjekësor i qendrës mjekësore/spitalore bëjnë shënimet përkatëse në librin e vizitave mjekësore dhe kartelën personale të të arrestuarit/ndaluarit.
- 4.17 Kur një i ndaluar/arrestuar ka shenja të një sëmundje ngjitëse merren këto masa:
- Personi mbahet i izoluar në dhomë i ndarë nga personat e tjerë,
 - Sendet personale të tij mbahen më vete dhe të ambalazhuara qese të veçanta plastike.
 - Merren masa për dërgimin e tij në qendrat e specializuara spitalore për këtë sëmundje.
 - Dezinfektimin e ambientit ku ka qëndruar i sëmurit si dhe i sendeve që janë përdorur prej tij.
 - Përcaktohen masat profilaktike e mjekësore që duhet të merren ndaj personelit të shërbimit që kanë qenë në kontakt me të sëmurin, etj.
- 4.18 Personeli policor dhe stafi mjekësor duhet të vlerësojnë çdo pretendim apo ankesë të ndaluarve/arrestuarve për shqetësime shëndetësore duke marrë masa për vërtetimin e vërtetësisë ose jo të pretendimeve.
- 4.19 Për të ndaluarit/arrestuarit që janë në trajtim mjekësor, personeli mjekësor jep me shkrim rekomandimet dhe këshillat për përdorimin e barnave duke i pasqyruar në kartelën/dosjen mjekësore të ndaluarit/arrestuarit. Kopje me shkrim të rekomandimeve për përdorimin e medikamenteve i jepen dhe përgjegjësit të dhomave të sigurisë, i cili ndjek zbatimin e tyre, si dhe i administron në fashikullin/dosjen e të arrestuarit/ndaluarit.
- 4.20 Për çdo vizitë mjekësore që realizon mjeku i strukturës policore, mjeku i urgjencës, apo mjekë të tjerë specialistë, në kartelën mjekësore të hapur nga mjeku i institucionit duhet të pasqyrohen të dhënat si: ora dhe vendi i vizitës mjekësore, problemet mjekësore, diagnoza dhe mjekimi së bashku me mënyrën e përdorimit dhe doza e medikamentit që duhet të marrin personat.
- 4.21 Kur konstatohen shenja apo ka ankesa për përdorim dhune merren këto masa:
- Hartohet procesverbali i verifikimit paraprak sipas përcaktimeve të bëra në germën “a” dhe “e” të pikës 7 të Kreut të V të procedurës, ku pasqyrohen dëmtimet dhe pretendimet e të arrestuarit/ndaluarit.
 - Njoftohet menjëherë shefi i komisarariatit të policisë/drejtori vendor i policisë, të cilët vlerësojnë dhe marrin masa për trajtimin ligjor të rastit për personat përgjegjës si ato disiplinore/administrative dhe penale.
 - Vënë në dijeni organin e prokurorisë së rrethit gjyqësor për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore.
 - Vënë në dispozicion të organit të prokurorisë kopje të procesverbalit të verifikimit paraprak.”

Avokati i Popullit për të bërë të mundur shqyrtimin e hetimit administrativ të rastit, bazuar në nenin 63, paragrafi i katërt i Kushtetutës, ku parashikohet se: “Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”, në ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, respektivisht në nenin 19, germa “b” të ku parashikohet se: “Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura,

Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”, në nenin 20 ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë edhe informacione apo dokumente, që lidhen me çështjen në shqyrtim, të klasifikuara si sekret shtetëror. Në këto raste, ai është i detyruar të respektojë kërkesat për ruajtjen e sekretit shtetëror”, si dhe në paragrafin e fundit të nenit 19 ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme”, i është drejtuar me kërkesë për informacion institucioneve: Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore me shkresën nr.K4/I29-2 Prot.“Kërkesë për informacion”, “Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” me shkresën nr. K4/I29-9 Prot,“Kërkesë për vënien në dispozicion të kopjes së kartelës mjekësore të shtetasit J.R” Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë me shkresën nr. K4/I29-5 Prot, “Kërkesë për dokumentacion dhe informacion” dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore me shkresën nr. K4/I29-3” Prot, “Kërkesë për vënien në dispozicion të kopjeve të ekspertizës mjeko-ligjore të shtetasit Jani Rustemi”. Në përgjigjen e tyre institucionet na bëjnë me dije se më poshtë vijon:

Me shkresën Nr. 1352/1 Prot, datë 11.05.2023 “Kthim përgjigje”, Agjencia e Mbikëqyrjes Policore na bën me dije se: Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, ka kryer verifikime të detajuara, gjithëpërfshirëse duke filluar me administrimin e kallëzimit të datës 30.04.2023, të pretendimeve të shtetasës Pranvera Rustemi, nëna e shtetasit Jani Rustemi. Në kallëzim ajo sqaron se në datë 12.04.2023, djali i saj është arrestuar nga policia duke i ushtruar kontroll në banesën ku jetojnë. Në datë 15.04.2023 është telefonuar nga një punonjës policie i cili i ka kaluar në telefon djalin e saj dhe i ka kërkuar pasaportën e tij. Në datën 28.04.2023, në banesën e saj kanë shkuar dy punonjës policie të cilët e kanë sqaruar se djali i saj ishte sëmurë dhe ndodhej në Spitalin Universitar “Nënë Tereza”. Në datë 29.04.2023 nëna ka shkuar në spital dhe aty ka parë djalin e saj të shtruar në pavijonin e reaminacionit në gjendje jo të mirë shëndetësore. Gjatë komunikimit që ka patur me mjekun, ky i fundit i ka sqaruar se gjendja e djalit të saj nuk ishte e mirë si pasojë e dozës së madhe të ilaçeve që i kanë dhënë. Në momentin që ka parë djalin në spital, nuk ka konstatuar shenja dhune në trupin e tij.

Pas marrjes së kallëzimit të shtetasës Pranvera Rustemi, janë kryer veprimet e para hetimore. Është administruar kartela mjekësore e shtetasit Jani Rustemi pranë QSUT Tiranë, është administruar praktika dhe dinamika e shtetasit Jani Rustemi në bllokun e sigurisë DVP- Tiranë, janë marrë deklaramime të punonjësve të policisë dhe mjekut që e ka mjekuar në bllokun e sigurisë të DVP- Tiranë, nga ku rezulton si më poshtë:

Më datën 12.04.2023 nga shërbimet e policisë të Komisarariatit Nr.2 Tiranë, është arrestuar shtetasi Jani Rustemi, i dt. 15.04.2023, për veprën penale “Vjedhje”

parashikuar nga neni 134 i Kodit Penal. Materialet hetimore i janë referuar Prokurorisë nga Komisariati i Policisë Nr.2 Tiranë, me shkresë Nr.3218/k Prot, datë 13.04.2023. Në datë 14.04.2023, kohë në të cilën ky shtetas ka qenë në bllokun e sigurisë së DVP-Tiranë, ka shfaqur shqetësime shëndetësore. Nga strukturat që merren me sigurimin e të ndaluarve dhe arrestuarve është njoftuar shërbimi i emergjencës mjekësore, të cilët janë paraqitur në ambientet e bllokut të sigurisë. Pas ndihmës mjekësore të dhënë, gjendja shëndetësore është përmirësuar. Në datë 15.04.2023 shtetasi i arrestuar Jani Rustemi është shoqëruar në ambientet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku kjo gjykatë ka vendosur masën e sigurisë “*Arrest në burg*”. Në datë 16.04.2023 pas daljes së urdhrin të ekzekutimit të masës së sigurisë nga Prokurori, është përgatitur dokumentacioni i nevojshëm, dhe ky i arrestuar është dërguar pranë IEVP-313 Tiranë. Autoritetet e IEVP-313 nuk e kanë pranuar që ta marrin në dorëzim, me argumentin se nuk i pranojnë të ndaluarit që karakterizohen si përdorues të drogave të forta të llojit heroinë, por edhe për faktin që i ndaluarit ka deklaruar në këtë institucion ka probleme hasmërie. Në këto kushte ai është rikthyer dhe vendosur përsëri në bllokun e sigurisë Tiranë. Në datë 17.04.2023, në orën 4 e 15 minuta shtetasi Jani Rustemi ka shfaqur përsëri shqetësime shëndetësore dhe si pasojë është transportuar në spitalin Nënë – Tereza ku dhe është shtruar.

Punonjësit e policisë të planizuar në shërbimin turni i tretë nga ora 22.00 deri 06.00 të datës 17.04.2023 në dhomat e sigurisë në katin e dytë, me detyrë ruajtjen dhe sigurimin e të ndaluarit/arrestuarit, kanë sqaruar se rreth orës 04.15 të datës 17.04.2023 kanë dëgjuar një zhurmë që vinte nga dhoma nr.27, ku ishte akomoduar shtetasi Jani Rustemi . Janë afruar dhe kanë konstatuar se shtetasi Jani Rustemi kishte rënë nga krevati në dysheme, pa ndjenja dhe me gjakderdhje nga goja. Kanë njoftuar menjëherë përgjegjës të informacionit i cili ka njoftuar menjëherë ambulancën.

Mjeku përgjegjës i DVP-Tiranë ka sqaruar se e ka vizituar shtetasin Jani Rustemi nga data 13.04.2023 deri më datë 16.04.2023, çdo ditë në mëngjes. Konkretisht për herë të parë e ka vizituar më datë 13.04.2023 dhe gjatë vizitës e pohimeve të shtetasit Jani Rustemi, ka mësuar se ishte përdorues i lëndës narkotike të llojit “heroinë” dhe merrte rreth 10 gram në ditë. Personat që marrin sasi të tilla të lëndës narkotike të llojit “heroinë, trajtohen me antidotin të quajtur “Metadon”. Pas verifikimeve që ka kryer pranë Shoqatës “Aksion Plus”,(shoqatë e cila është e certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë, si i vetmi që shpërndan medikamentin Metadon), ka rezultuar se ky shtetas ishte i regjistruar pranë kësaj shoqate dhe merrte dozë ditore 40 mg. Nisur nga ky verifikim ka plotësuar kartelën shëndetësore të shtetasit Jani Rustemi, ku ka shënuar diagnozën e tij e cila ishte “Toksikomani” dhe mjekimin përkatës me “Metadon” në dozën prej 40 mg në ditë, dozë të cilën ia ka dhënë çdo 24 orë.

Gjatë qëndrimit në bllokun e sigurisë, ky shtetas në vazhdimësi është ankuar për abstinencë (mungesë/varësi) të lëndës narkotike të llojit “heroinë”, duke kërkuar gjithnjë doza më të mëdha të “Metadonit”. Pavarësisht kësaj, nga ana e mjekut është ndjekur me rigorozitet mjekimi me “Metadon” vetëm me dozën e përcaktuar prej 40 mg çdo 24 orë. Gjatë datave që ky shtetas ka qëndruar në bllokun e sigurisë, është lajmëruar ambulanca në dy raste, ku i është dhënë ndihmë mjekësore duke e trajtuar me qetësuesin Diazepam (valium) ampulë.

Mjeku ka sqaruar se këtë medikament “Metadon”, e marrin nga shoqata “AksionPlus”, pas kërkesës që bëhet nga DVP-Tiranë. Pasi merret në administrim, ky medikament përdoret vetëm për personat të cilët janë të ndaluar/arrestuar në bllokun e sigurisë (*dhomat e ndalimit të shtetasve të arrestuar/ndaluar, pranë DVP-Tiranë*). Këtyre personave iu jepet ky medikament vetëm nëse janë të regjistruar pranë shoqatës “Aksion Plus”. Informacionin nëse janë apo jo të regjistruar pranë kësaj shoqate e sigurojnë nëpërmjet komunikimit telefonik me ta. Rezulton se shtetasi Jani Rustemi shënohet në listën e shpërndarjes së metadonit. Në listë konfirmohet gjithashtu se ky shtetas është trajtuar në datat 13,14 dhe 15.04.2023, me medikamentin “Metadon” në masën prej 40 mg çdo 24-orë. Veprimet procedurale së bashku me provat e administruara nga ana jonë për hetimin paraprak të rastit, i janë referuar Prokurorisë së Rrethit Gjiqësor Tiranë, me shkresën nr.168 Prot, datë 02.05.2023, kopje e të cilës ju vihet në dispozicion bashkëlidhur.

Më shkresën nr.6441/1 Prot datë 11.05.2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjiqësor Tiranë na konfirmon se: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mbi bazën e materialit të referuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Policore, ku ka paraqitur kallëzim shtetasja Pranvera Rustemi në lidhje me gjendjen shëndetësore të djalit të saj Jani Rustemi. Në datë 09.05.2023. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka regjistruar procedimin penal nr.5399 të vitit 2023. Çështja është ende në shqyrtim.

Me shkresën nr.12417/1 Prot datë 08.11.2023, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë na informon se, më datë 22.05.2023 është regjistruar procedimi penal nr.3283 të vitit 2023, për veprën penale “Neglizhenca në trajtimin mjekësor”, parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal. Çështja është ende në fazën e hetimeve paraprake dhe dosja është deleguar për hetime të mëtejshme pranë Autoritetit të Mbikëqyrjes Policore. Në këtë fazë të hetimeve, nuk mund të na venë në dispozicion kopje të akteve.

Me shkresën nr.1134/3.Prot datë 30.05.2023 “Kthim përgjigje”, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” na dërgon një kopje të kartelës klinike të shtetasit Jani Rustemi në të cilën përcaktohet qartë shtrimi i pacientit, qëndrimi së bashku me trajtimin mjekësor si dhe dalja e pacientit. Në kartelën mjekësore hyrja e pacientit

është regjistruar në datën 17.04.2023 ora 04:40 dhe humbja e jetës (exitus letalis) më datë 20/05/2023. Në Amnezë përcaktohet se pacienti sillet nga urgjenca në gjendje kome. Pacienti nuk reagon ndaj komandave. Referojnë se ka patur episod të vjellash më gjatë e vihet re gjak i mpiksuar në mushkëri, ndërsa mjekimet e përdorura më herët referohet “Metadon”.

Me shkresën Nr. 4267/7 Prot, datë 09.10.2023 “Kthim përgjigje”, Instituti i Mjekësisë Ligjore na dërgon kopje të ekspertimit Mjeko-Ligjor me Nr.231, “Mbi ekzaminimin e kufomës së shtetasit Jani Rustemi”. Bazuar në të dhënat e vendimit për kryerjen e ekspertimit rezulton se më datë 21.05.2023, është njoftuar se, në morgun e IML Tiranë është sjellë kufoma e shtetasit Jani Rustemi, i cili ka qënë i shtruar në pavionin e Reaminacionit të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”. Tiranë që prej datës 17.04.2023. Mbështetur në të dhënat përkatëse, IML ka arritur në përfundimin se: 1. Në trupin e kufomës së shtetasit Jani Rustemi nga këqyrja e jashtme u konstatuan mbetje të vjetra plagësh në të dy krahët. Nga këqyrja e brendshme, ekzaminimet histopatologjike u konstatua Kardiomiopatia Fibriotike, Ishemi akute Miokardi. Pleuropneumopatia kronike. Trumb vazal pulmonar. Edemë e shprehur e trurit. Hepatit kronik presistent. Pankratit kronik presitent. Pankratit kronik . Stazë vazale e shprehur. 2. Mbetjet e vjetra të plagëve të vërejtura në të dy krahët janë shkaktuar me mjet prerës-shpues, siç mund të jetë thika. Ndryshimet organore janë pasojë e sëmundjeve nga të cilat ka vuajtur viktimja. 3. Shkaku i vdekjes së shtetasit Jani Rustemi ka qënë patologjia kardio-pulmonare me mekanizmin e insuficiencës kardio-respiratore.

Në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit problematikat e konstatuara në lidhje me rastin konkret janë:

- 1. Mosdhënia e ndihmës mjekësore nga komisarati nr.2 Tiranë, gjatë kohës së qëndrimit në këtë komisarati të shtetasit Jani Rustemi. Nga punonjësit e shërbimit është konstatuar axhitimi i këtij personi dhe janë konstatuar sjellje jo normale të tij (raporti-shërbimi i mbajtur në dt.12.04.2023 nga punonjësi i policisë të komisarati Nr.2 Tiranë, por ndihma mjekësore nuk është dhënë në mënyrë të menjëhershme.*
- 2. Ka një neglizhencë nga mjeku i bllokut të sigurisë për trajtimin dhe konsultimin e rastit me mjek specialistë, për të përcaktuar llojin dhe dozën e mjekimit (Metadonit), që duhet të përdorte personi i arrestuar/ndaluar, si dhe për të përcaktuar kohën kur ka marrë metadon. Nëpërmjet ekzaminimeve të cilat janë kryer nuk është përcaktuar koha e fundit kur ky person ka marrë dozën e fundit para arrestimit. Vetëm në përfundim të këtyre ekzaminimeve, mjeku kontakton me shoqatën “Aksion-Plus” dhe me rekomandimin e mjekut toksikolog kërkon dozën e rekomanduar për trajtimin e personit.*

Është rasti të theksojnë se këto neglizhenca nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit dhe e detyrimit të këtyre të fundit për dhënien e ndihmës mjekësore janë evidentuar edhe më parë nga ana jonë. Në në disa rekomandime që u janë adresuar në vijimësi nga institucioni i Avokatit të Popullit strukturave vendore e qendrore të Policisë së Shtetit janë trajtuar këto shqetësime dhe është rekomanduar përmirësimi i punës por, me keqardhje konstatojmë se raste të tilla përsëriten në praktikën e përditshme. Ky fakt tregon se nuk njihen në nivelin e duhur aktet normative ligjore e nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e Policisë së Shtetit dhe detyrimet e punonjësve të policisë për të zbatuar e respektuar të drejtat e shtetasve të shoqëruar dhe arrestuar/ndaluar në mjediset e Policisë së Shtetit.

Gjithashtu vlerësojmë se një ndër shkaqet e përsëritjes së këtyre shkeljeve të të drejtave të qytetarëve është mos instruktimi i vazhdueshëm dhe mos ushtrimi i kontrollit të strukturave drejtuese të punonjësve të policisë ndaj vartësve të tyre.

Theksojmë se ngjarje të kësaj natyre cenojnë rëndë imazhin e Policisë së Shtetit dhe besimin e publikut tek ky institucion, të cilat janë të domosdoshme në kryerjen me sukses të misionit ligjor të saj për ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit ligjor të parashikuar në nenin 2 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, *si nxitës i standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend*, gjykon se bazuar në evidentimin e problematikave të lartpërmendura, lind nevoja e një reagimi më të fortë nga strukturat e Policisë së Shtetit, për të garantuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve nga Punonjësit e Policisë së Shtetit.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike” dhe në bazë të nenit 21/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”:

REKOMANDOJMË

1. Marrjen e masave për zbatimin efektiv të garancive ligjore të qytetarëve në lidhje me ruajtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së tyre nga punonjësit e

Policisë së Shtetit, gjatë kohës së privimit të lirisë të personit në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë.

2. Marrjen e masave të nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për evidentimin e rastit dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete administrative për shkeljet e konstatuara, nga hetimi administrativ i kryer nga Institucioni i Avokatit të Popullit që lidhen konkretisht me:

- ✓ *Mosdhënien e ndihmës mjekësore nga Komisariati nr.2 Tiranë, gjatë kohës së qëndrimit në këtë komisarjat të shtetasit Jani Rustemi, edhe pse nga punonjësit e shërbimit është konstatuar axhitimi i këtij personi dhe sjellje jo normale të tij (**raporti-shërbimi i mbajtur në dt.12.04.2023 nga punonjësi i policisë të Komisarjatisë Nr.2 Tiranë**).*
- ✓ *Ka një neglizhencë në kryerjen e detyrës nga mjeku i bllokut të sigurisë për trajtimin dhe konsultimin e rastit me mjekë specialistë, për të përcaktuar llojin dhe dozën e mjekimit (Metadonit), që duhet të përdorte personi i arrestuar/ndaluar.*

3. Marrja e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për trajnimin në vijimësi të punonjësve të policisë efektive të strukturave të Policisë së Shtetit lidhur me njohjen e akteve normative që rregullojnë veprimtarinë e këtij organi, rastet dhe kriteret e arrestim/ ndalimit dhe respektimin e të drejtave ligjore të personave të arrestuar/ndaluar, e në veçanti trajtimin e këtyre shtetasve në rastin kur ata janë përdorues të lëndëve narkotike.
4. Përgjithësimin e këtij rasti në të gjitha strukturat vendore të Policisë së Shtetit, me qëllim mos përsëritjen e shkeljeve të tilla në të ardhmen nga punonjësit e policisë.

KOMISIONER

Ahmet Prenci